

Pëlqim i përgjithshëm

Studimi ynë për shëndetin tuaj



Na mbështesni që të mund të vazhdojmë
të kryejmë studime për të përmirësuar
vazhdimisht trajtimin tonë për ju.

Të nderuar pacientë, të nderuar prindër,

Zbulimi dhe trajtimi i sëmundjeve ka shënuar zhvillime të mëdha në
dekadat e fundit. Ky zhvillim është rezultat i shumë viteve studimesh,
në të cilat janë përfshirë mjekë, shkencëtarë dhe pacientë të brezave
të ndryshëm.

Studimi varet së tepërmi nga të dhënat nga historiku mjekësor i
pacientit. Këto mund të jenë p.sh. rezultatet nga analizat laboratorike,
informacioni rreth terapisë apo rreth predispozitave të trashëguara
ndaj sëmundjeve të caktuara. Materiali biologjik që është marrë si
mostër gjatë një qëndrimi spitalor dhe që nuk nevojitet më për qëllime
diagnostike është gjithashtu tepër i çmuar për studime. Këto mostra të
mbetura mund të jenë p.sh. gjaku, urina apo mostra të indeve.

Falënderime të përzemërta për mbështetjen tuaj!



Mësoni më shumë
për studimin pranë
LUKS dhe për pëlqi-
min e përgjithshëm
te luchs.ch/gk



All Information in different languages
available




Informacion për përdorimin e mëtejshëm të të dhënave dhe mostrave të lidhura me shëndetin për qëllime studimi

Ky informacion shpjegon se si mund të kontribuoni në avancimin mjekësor dhe tregon se si mbrohen të dhënat dhe të drejtat e pacientit.

Kontributi juaj në studim

Nëse nënshkruani me "Po" në formularin e pëlqimit më poshtë, do t'i vendosni të dhënat dhe mostrat e mbetura në lidhje me shëndetin në dispozicion të studimeve. Pëlqimi vlen për të gjitha të dhënat që janë mbledhur tanimë në spital ose që do të mbledhen në të ardhmen. Kjo vlen me të njëjtin kuptim për mostrat.



Pëlqimi është me vullnet të lirë dhe i vlefshëm për periudhë pa afat nëse nuk revokohet (tërhiqet). Pëlqimin mund ta revokoni në çfarëdo kohe përmes adresës së kontaktit që jepet në formular, pa qenë nevoja të jepni justifikime. Pas revokimit, të dhënat dhe mostrat nuk do të vihen më në dispozicion të projekteve studimore. Vendimi juaj nuk ndikon në trajtimin mjekësor.

Avantazhet dhe disavantazhet

Nuk ka kosto të mëtejshme për ju. Ndalohet me ligj që të gjenerohen para nga të dhënat dhe mostrat e tilla. Ndaj nuk ka ndonjë avantazh financiar për ju apo për spitalin.

Projektet studimore me të dhënat dhe mostrat e pacientit zakonisht nuk japin informacione që të jenë drejtpërdrejt të rëndësishme për shëndetin e një individi të caktuar. Por nëse gjendet ndonjë rezultat i rëndësishëm dhe merret masë mjekësore, ka mundësi të bëhet kontakt me spitalin.




Përdorimi i të dhënave dhe mostrave të lidhura me shëndetin



Të dhënat dhe mostrat do t'u vihen në dispozicion studiuesve të autorizuar në spitalin tonë për projekte studimore ose mund të përdoren në projekte studimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private (spitale të tjera, universitete ose kompani farmaceutike).

Projektet mund të zhvillohen në Zvicër ose jashtë shtetit dhe, nëse është nevoja, të përfshijnë analiza gjenetike. Për projekte studimore jashtë shtetit vlejnë të paktën të njëjtat kërkesa për mbrojtjen e të dhënave si në Zvicër. Projektet studimore në përgjithësi i nënshtrohen shqyrtimit nga komisioni përgjegjës i etikës.

Përdorimi dhe mbrojtja e të dhënave dhe e mostrave



Të dhënat ruhen në spital në përputhje me dispozitat juridike. Vetëm punonjësit e autorizuar të LUKS, si p.sh. mjekët, kanë akses në të dhënat e pakoduara të historikut mjekësor dhe te mostrat e pakoduara. Mostrat ruhen në biobanka. Biobanka mundëson një grumbullim të strukturuar të mostrave të ndryshme sipas rregulloreve të caktuara të sigurisë (rregulloret për biobankat).

Nëse të dhënat dhe mostrat përdoren për projekte studimore, ato kodohen ose anonimizohen. Kodim do të thotë se të gjitha të dhënat, si emri dhe datëlindja, zëvendësohen me kode. Çelësi që tregon se cili kod i përket cilit person, ruhet nga një person që nuk është i përfshirë në projektin studimor. Personat që nuk kanë akses te çelësi, nuk kanë mundësi t'i identifikojnë të dhënat dhe mostrat. Nëse të dhënat dhe mostrat anonimizohen, atëherë nuk ka çelës që të mundësojë gjurmimin mbrapsht te personi.

Deklarata e pëlqimit për ripërdorimin e të dhënave dhe të mostrave në lidhje me shëndetin

Etiketa e pacientit
(me emër-mbiemrin, si dhe datëlindjen)

Emër-mbiemri i pacientit

Datëlindja

Nëpërmjet kësaj bie dakord

që të dhënat dhe mostrat e mbledhura apo të marra gjatë qëndrimit me shtrim apo vizitë në spital të vihen në dispozicion për
nevoja studimore.

Jam në dijeni se

Po

Jo

- fleta informuese (versioni 4.0/K/15.03.2023) përshkruan dispozitat për përdorimin e mëtejshëm të të dhënave dhe mostrave. E kam lexuar dhe kuptuar këtë informacion.
- të dhënat personale janë të mbrojtura.
- të dhënat dhe mostrat mund të përdoren në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, brenda institucioneve publike dhe private.
- mostrat mund të përdoren për qëllime studimore dhe për analiza gjenetike.
- pacienti mund të kontaktohet nëse evidentohet informacion që ka rëndësi për të.
- vendimi është me vullnet të lirë dhe nuk ndikon mbi trajtimin.
- vendimi është i vlefshëm për periudhë pa afat.
- pëlqimi mund të tërhiqet në çfarëdo kohe pa dhënë justifikim.

Vendi dhe data

Nënshkrimi (nëse ka aftësinë të vendosë)

Për adoleshentë dhe fëmijë nën 18 vjeç

- Për fëmijët dhe adoleshentë nën 14 vjeç, pëlqimin e japin prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë.
- Të rinjtë e moshës 14 deri në 18 vjeç vendosin vetë nëse dëshirojnë të japin pëlqimin, por rekomandohet që ta nënshkruajnë prindërit ose kujdestarët e tyre ligjorë.

Emri i prindërve ose i kujdestarit ligjor dhe referenca me pacientin

Vendi dhe data

Nënshkrimi (nëse ka aftësinë të vendosë)

Do të merrni një kopje të kësaj faqeje me nënshkrimin nëse dëshironi.
Për pyetje kontaktoni me mjekun përgjegjës ose